



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2801 prot.

Elbasan, me 04.11.2022

VENDIM

Nr 30 datë 04.11.2022

Për

**miratimin në kufirin maksimal të pagave të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit
"Aleksandër Xhuvani" për secilin pozicion pune.**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE " Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; VKM-së Nr. 75 datë 12.02.2018 "Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", VKM-n nr. 647, datë 05.10.2022 "Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.06.2009 'Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë', i ndryshuar", Vendimit të Senatit Akademik Nr. 05, datë 17.02.2021 "Për miratimin e planbuxhetit vjetor 2022", Vendimi i Senatit Akademik nr. 21, datë 03.11.2022 "Për miratimin në kufirin maksimal të pagave të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për secilin pozicion pune", VBA Nr. 7 datë 09.03.2022 "Për miratimin e planbuxhetit të vitit 2022", i ndryshuar , Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 04.11.2022,

VENDOSI:

1. Miratimin në kufirin maksimal të pagave të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" (sipas Lidhjes nr. 1, pikës II. 2) në VKM-n nr. 647, datë 05.10.2022 "Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.06.2009 'Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë', i ndryshuar".
2. Burimi i financimit nga kufiri minimal deri në kufirin maksimal të përballohen nga të ardhurat që realizon UE për shërbimet ndaj të tretëve në Laboratorin kërkimor FSHN, të ardhurat nga të tretë (të diplomuarit në këtë universitet) për programe mësimore, vërtetim note pas diplomimit (dublikatë), tarifave të aplikimit në master , tarifat e regjistrimit, qira e mjediseve etje.
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
Dr. Ardian Durmishi

